




BULETINI M U J O R I

SHKURT 2026



► Fondi Social - Garanci për qëndrueshmërinë e shërbimeve për mirëqenien e qytetarëve

Zgjerohet numri i bashkive përfituese të Fondit Social Kombëtar, me 14 shërbime të reja që e çojnë në 98 numrin total të shërbimeve sociale në vend. Në eventin “Fondi Social 2026 - Garanci për Qëndrueshmërinë e Shërbimeve për Mirëqenien e Qytetarëve”. Kryeministri Edi Rama vlerësoi transformimin e sistemit social, që sot mbështet 65 mijë individë, ndërsa ministria e MSHMS prof. Evis Sala theksoi se shërbimet do të forcojnë mbështetjen për fëmijët, familjet në nevojë, personat me aftësi ndryshe, të moshuarit dhe viktimat e dhunës.



► Qendra Spitalore "Shefqet Ndroqi" merr Kartën e Autonomisë Menaxheriale

Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës "Shefqet Ndroqi" merr zyrtarisht Kartën e Autonomisë Menaxheriale, duke e çuar në 12 numrin e spitaleve në vend që e kanë përfituar këtë status, që nga hyrja në fuqi e ligjit për autonominë spitalore, në vitin 2022.

Gjatë vizitës në këtë spital, Ministrija e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, e cilësoi këtë moment si një hap të rëndësishëm në konsolidimin e reformës së autonomisë spitalore dhe i hap rrugën autonomisë financiare të institucioneve shëndetësore publike.



► Shqipëria dhe Italia drejt marrëveshjes për shëndetin publik

Shqipëria dhe Italia forcojnë bashkëpunimin në fushën e shëndetit publik. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Prof. Evis Sala, zhvilloi një takim me Presidentin e Istituto Superiore di Sanità (ISS), Prof. Rocco Bellantone, ku u diskutuan hapat konkretë për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet ISS dhe Institutit të Shëndetit Publik të Shqipërisë, me fokus në forcimin e sistemeve laboratorike, survejancën e sëmundjeve infektive dhe të rezistencës antimikrobale (AMR), shëndetin mjedisor si dhe monitorimin e sëmundjeve jo të transmetueshme.



► OBSH, Kopenhagen/ Ministria Sala prezanton prioritet në shëndetësi

Në Ditën e Shqipërisë në Zyrën Europiane të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof.Evis Sala, prezantoi vizionin e qeverisë shqiptare për zhvillimin e një sistemi shëndetësor modern, të qëndrueshëm dhe plotësisht të harmonizuar me standardet evropiane duke theksuar ristrukturimin e shërbimit spitalor, reformën në shërbimin e onkologjisë dhe integrimin e IA në shëndetësi.



► Dita Botërore e Kancerit, u mbajt forumi “Kontrolli i Kancereve në Shqipëri: Parandalim, Depistim dhe Kujdes ndaj pacientit”

Në kuadër të Ditës Botërore të Kancerit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, mori pjesë në forumin “Kontrolli i Kancereve në Shqipëri: Parandalim, Depistim dhe Kujdes ndaj pacientit”, organizuar nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), ku theksoi angazhimin e qeverisë për një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar në luftën kundër kancerit.



► 71 Spitale dhe Qendra Shëndetësore të Akredituara për vitin 2025

Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor ka përmbyllur me sukses procesin e akreditimit për vitin 2025, me 71 spitale dhe qendra shëndetësore të akredituara duke garantuar shërbime më të sigurta dhe me standarde më të larta për qytetarët.



► Për herë të parë në Shqipëri do të instalohet teknologjia diagnostikuese “Next Generation Sequencing”

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof.Evis Sala deklaroi se si pjesë e vizionit të zhvillimit të diagnostikës në shëndetësi, për herë të parë do të instalohet më vend teknologjia “Next Generation Sequencing” për identifikimin e sëmundjeve të rralla.



Next-Generation Sequencing



► Dubai/ Shqipëria merr pjesë në forumin World Health Expo

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, mori pjesë në World Health Expo (WHX Dubai) 2026, ku prezantoi progresin dhe sfidat e Shqipërisë në shëndetësinë digjitale, duke theksuar rëndësinë e kalimit nga dokumentet në letër drejt platformave kombëtare që përdoren çdo ditë nga mjekët dhe institucionet shëndetësore.



► Workshop Kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve në internet


MSHMS organizoi Workshopin Kombëtar për forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional në mbrojtjen e fëmijëve në internet, në bashkëpunim me CRCA Shqipëri, ALO 116-111 dhe **iSIGURT.al**.

Vetëm në 5 vitet e fundit janë trajtuar mbi 2,500 raportime që lidhen me sigurinë e fëmijëve në internet.



► Instalohet kabineti i ri i audiometrinë në Shërbimin ORL, Spitali Francez


Në shërbimin ORL, në Spitalin Francez është vënë në funksion kabineti i ri i audiometrisë së folur dhe në fushë të hapur me teknologji sipas standardeve europiane, i vetmi i këtij lloji në vend, që garanton vlerësim të saktë të dëgjimit dhe ndjekje më cilësore të pacientëve.



► Nis faza III e programit “Askush të mos mbetet pas”

Nis faza e III- të e programit “Askush të mos mbetet pas”, zbatuar nga UNDP, UNICEF, UNFPA dhe UN Women në bashkëpunim me MSHMS për t’iu përgjigjur pririteteve kombëtare dhe nevojave të komunitetit në nivel vendor.





BULETINI M U J O R I

SHKURT 2026